



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080
- Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Kërkesën e KOSTT SH.A për derrogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit të datës 21 tetor 2010,

në seancën e mbajtur më 11 nëntor 2010 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

I lejohe KOSTT SH.A. derrogimi i zbatimit të dispozitave të neneve të **Kodit të Rrjetit** dhe të **Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit**, si në Shtojcë të këtij vendimi.

ARSYETIM

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 21 tetor 2010 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A për derrogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit. Pas vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale të Sistemit të Transmisionit, ZRrE ka parë të arsyeshme që të lejojë derrogimin e zbatimit të dispozitave të neneve të Kodit të Rrjetit dhe të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit në afatet e vendosura si në Shtojcë.

Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit mbesin në fuqi.

Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: Derrogimet e lejuara.

Bordi i ZRrE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar